- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Vlerësimit;
 - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 - 6. Preventivin e çmimeve
 - 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

² Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërat në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 8 jave

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: : sipas Shtojcës 7

2.2. Kapaciteti Ekonomik Dhe Financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

- 2.2.1. Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.
- 2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin bilancet vjetore, per vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024**, te shoqeruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetem ne rastin kur jane ne kushtet e percaktimeve te *ligjit Nr.10 091, date 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve te njepasnjeshme, nuk duhet te kene raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave** vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2023** dhe për vitin **2024** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës

2.3. Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përse i përket aftësisë teknike e profesionale

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllëguar të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 1/a) plotësohet nga anetari i cili ka përqindjen me të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anetaret e tjera të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. ***Kurse 1/pika b)*** duhet të plotësohet nga të gjithë anetaret e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

- **Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**

- a)** Kontraten e Siper marrjes,
- b)** Situacionin përfundimtar të objektit
- c)** Fatura Tatimore
- d)** Aktin e Kolaudit të objektit
- e)** Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
- f)** Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- **Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

- a)** Kontraten e Siper marrjes,

-
- b) Situacionin perfundimtar te objektit
 - c) Faturat Tatimore
 - d) Aktin e Kolaudimit te objektit
 - e) Formular Vleresimi nga Investitori sipas shtojces nr. 9

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve, prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit si dhe preventivin e ndarjes së punëve.

2.3.2. Operatorët ekonomikë duhet të deshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar.

Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **Kategoria NP-1** – Punime Germimi në tokë – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-2** – Ndërtime civile dhe industriale – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-3** – Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada – **Klasifikimi C**
- **Kategoria NP-12** – Punime të inxhinierisë së mjedisit – **Klasifikimi A**

Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:

- **Kategoria NS-1** – Punime për prishjen e ndërtimeve – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-2** – Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-4** – Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese – **Klasifikimi B**
- **Kategoria NS-8** – Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-12** – Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-14** – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV – **Klasifikimi A**

– **Kategoria NS-18** – Punime topogjeodezike – **Klasifikimi A**

** Per Operatoret e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e licenses profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

** Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t'i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.*

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese Çertifikaten ISO, si me poshte:

- **ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit te Cilesise)**
- **ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)**
- **ISO 45001:2018 (Sistem i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune)**
- **ISO 50001-2018 (Sistemi i Menaxhimit të Energjise)**
- **ISO 3834-2:2021 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Saldim me Shkrirje të Materialeve Metalike)**

Çertifikatat e mesiperme duhet te jene te vlefshme ne daten e hapjes se ofertave. Nese certifikata eshte ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohet me perkthimin ne gjuhen shqipe te noterizuar. Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike ISO duhet plotesuar nga operatoret ekonomike, sipas natyres se puneve qe marrin persiper.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet te kete nje punesimin mesatar jo me pak se 90 (nentedhjete) punonjës për periudhën e 3 muajve te fundit nga data e hapjes së ofertave.

Per vertetimin e ketij kushti te paraqiten:

1. Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj per periudhen e mesiperme.
2. Listepagesa e Kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore per periudhen e mesiperme.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet te disponoje stafin kryesor e mbeshtetes, punonjesit specialiste dhe çertifikimet perkatese, si me poshte:

a) Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te kene ne license te shoqerise e te punesuar si drejtues Teknik ne staf, per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome, CV, si dhe te figurojne detyrimisht ne listpagesat e shoqerise per periudhen e 3 muajve te fundit, stafin inxhinierik si me poshte:

- 1 (nje) **Arkitekt**
- 1 (nje) **Inxhinier Ndërtimi (profili Strukturist)**
- 1 (nje) **Inxhinier Mekanik**

- 1 (nje) **Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder**
- 1 (nje) **Inxhinier Mjedisi**
- 1 (nje) **Inxhinier Hidroteknik**
- 1 (një) **Inxhinier Gjeoteknik**
- 1 (nje) **Inxhinier Elektrik**
- 1 (nje) **Inxhinier IT**

- Njëri nga drejtuesit teknik duhet të jetë i pajisur me "Çertifikatë për Auditues Energjitik në Ndërtesa", lëshuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë.
- Drejtuesi teknik, Inxhinieri IT duhet të jetë i pajisur me certifikate për ndertimin e rrjeteve të sistemeve të ndryshme si Cisco CCNP (Cisco Certified Network Professional) ose ekuivalente, lëshuar nga institucione të konsoliduara përsa i përket teknologjisë së informacionit.

*Për arsye verifikimi të vlefshmërisë së certifikatave të kërkuara si me sipër, Operatori/et ekonomik/e, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër/mbiemër, titullin e certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, datën e lëshimit të saj dhe emrin e autoritetit certifikues kompetent.

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".*

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë edhe stafin mbështetës inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (nje) **Inxhinier Ndërtimi (profili Transport)**
- 1 (nje) **Agronom**
- 1 (nje) **Inxhinier Gjeolog**

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mesiperm duhet të paraqesë: kontratë pune të vlefshme, diplome, si dhe të figurojnë detyrimisht në listat e shoqërisë për periudhën e 3 muajve të fundit.

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".*

c) Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listat e shoqërisë për periudhën e 3 muajve të fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesionet si më poshtë:

- 1 (nje) Teknik i mesëm Ndërtimi (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (nje) Teknik i mesëm Topograf / Gjeometer (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (një) Teknik i mesëm Mekanik (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (një) Teknik i mesëm Elektrik (Diplome e shkolles mesme)

- 1 (një) Teknik i mesem IT (Diplome e shkolles mesme)
- 3 (tre) Muratore (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 5 (Pese) Suvatues (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 1 (nje) Hidroizolues (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Saldatore (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Pergatites konstruksionesh metalike (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 4 (kater) Specialist fasade (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 5 (Pese) Shtrues pllakash (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Shtrues parketi (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 1 (nje) Mobilier / Marangoz (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Punonjes gipsi (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 3 (tre) Karpentier (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Betonues (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 3 (tre) Hekurkthyes (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 5 (Pese) Bojaxhinj (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Montues duralumini (dye dhe dritare) (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 4 (kater) Elektricitist (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Hidraulik (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 1 (nje) Montues i paneleve diellore (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 3 (tre) Punonjes per sistem ngrohje-ftohje (Me Certificate Trajnimi / Diplome)

* Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si:

- Kontratat e punes individuale te vlefshme
- Per stafin e mesiperm, Deshmia e kualifikimit/ certificate dhe/ose diploma e cila te jete e leshuar nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.*”, i ndryshuar.

Diplomat/certificatekat te paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licensuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumenta te rreme te cilat perbejne shkak per skualifikim dhe/ose perjashtimin e ketij kontraktori nga pjesemarrja ne prokurimet publike.

- Per specialistet e mesiperm te paraqiten Kartela personale te sigurimit teknik te vlefshme te leshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private te akredituara per certifikimin e punonjesve.
- **Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:**

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punonjesit ne certificate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certificate/diplomes	Numri indentifikues i certificate/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Lidhur me saldatoret e kerkuar si me siper, duhet te jene te kualifikuar sipas standardit SSH EN ISO 9606-1, sa i perket kerkesave per testimin dhe kualifikimin e saldatoreve per saldimin

e celiqeve, leshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Per permbushjen e ketij kriteri, operatori ekonomik ofertues, ne formularin permbledhes te vetdeklarimit, Deklarata B, duhet te deklaroje emer/mbiemer, titullin e certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, daten e leshimit te saj dhe emrin e organit certifikues kompetent.

Shenim: Referuar pikes 1, te nenit 26, te VKM nr.285, date 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit ne nenin 82, te LPP-se, dhe ne keto rregulla”*, si dhe percaktimet e pikes 6, te ketij neni, ku parashikohet: ***“Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin”***.

d) Operatori ekonomik pjesemarres duhet te deshmoje se ka te punesuar ne stafin e shoqerise punonjes te kualifikuar, te pajisur me Deshmi te Aftesive Profesionale (DAP), leshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si me poshte :

- Eskavatorist 1 (nje)
- Automakinist 1 (nje)
- Shofer 2 (dy)

(Ne rastet kur mjetet/makinerite disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar).

Per kete operatoret ekonomike duhet te paraqesin :

- Kontratat e punes te vlefshme;
- Dokument (deshmi kualifikimi profesional), qe te vertetoje kualifikimin profesional te kerkuar, referuar rregullores “Per kushtet, kriteret dhe programet per pergatitjen teoriko-praktike te kandidateve, si dhe dhenien e Deshmise se Aftesise Profesionale per perdoruesit e makinerive te renda per punime ndertime dhe toke, si dhe disiplinimi i perdorimit te tyre”, miratuar me urdherin nr. 200, date 16.5.2019, te Ministrit te Infrastruktures dhe Energjitikes.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8 te DST.

Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per tu kerkuar sqarime nga AK.

e) Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te kene te punesuar si staf mbeshtetes per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, te pajisur me certifikate/deshmi trajnimi te leshuar nga subjekte te licencuar/akredituar sipas ligjit, si dhe

te figurojnë në listpagesat e shoqërise për periudhën e *muajit të fundit*, punonjes me specialitetin si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë si Ekspert Zjarrfikës, për dhënien asistencës teknike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojë emer/mbiemer, titullin e certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organit certifikues kompetent.

- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet certifikata e trajnimit të lëshuar nga Kryqi i Kuq, ose organe të licencuara/akredituara nga Republika e Shqipërisë.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojë emer/mbiemer, titullin e certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organit certifikues kompetent.

- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”, lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojë emer/mbiemer, titullin e certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organit certifikues kompetent.

- 5 (pese) punonjës të pajisur me certifikatë “Për punimet në lartësi, lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojë emer/mbiemer, titullin e certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organit certifikues kompetent.

- 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe uje të nxehtë sipas ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, ku duhet të paraqitet certifikata e trajnimit të cilat të jetë lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojë emer/mbiemer, titullin e certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organit certifikues kompetent.

- 1 (një) punonjës, i pajisur me certifikatë si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit, lëshuar nga Instituti i Ndërtimit.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues, në formularin përmbledhës të

vetdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojë emer/mbiemer, titullin e certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organit certifikues kompetent.

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL), për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”.
- Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) Kodi III.2.A për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për produktet si më poshtë:

- **Tulle qeramike për murature:** Autorizim Prodhuësi/Distributori të autorizuar, të paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 772-1 (rezistenca në shtypje të elementeve të muratures) dhe SSH EN 9646 (Rezistenca termike dhe transmetimi termik i elementeve të muratures).
- **Shtrese parket druri:** Autorizim Prodhuësi/Distributori të autorizuar, të paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 13489 (referuar karakteristikave të elementeve të parketit prej druri) dhe SSH EN 13696 (përcaktimi i elasticitetit dhe rezistencës ndaj gërryerjes).
- **Hidroizolues me baze çimento, përgatitur nga dy komponente A+B:** Autorizim Prodhuësi/Distributori të autorizuar, të paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 7783 (përcaktimi i vetive së përhapjes ujë-avull).
- **Fasade me polisterol + rrjete + suva:** Autorizim Prodhuësi/Distributori të autorizuar, të paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 12667 (përcaktimi i rezistencës dhe cilesive termike të pllakes së polisterolit), SSH EN 13498 (përcaktimi i rezistencës ndaj penetrimit të ujit në sistemet e izolimit të jashtëm).
- **Dritare dhe dyer d/alumini plastike:** Autorizim Prodhuësi/Distributori të autorizuar, të paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 477 (përcaktimi i rezistencës në goditje të profileve plastike) dhe SSH EN 479 (përcaktimi i kthimit të nxehtësisë).
- **Bojë hidroplastike:** Autorizim Prodhuësi/Distributori të autorizuar, të paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 11998 (përcaktimi i aftësisë për t’u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lyrjes) dhe Certificate që vërteton se boja që do të aplikohet është Antimikrobiale/antibakteriale.

-
- **Ndricules Panel LED jashte murit, 60x60 cm, 40W:** Autorizim Prodhuksi/Distributori te autorizuar, te paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 62384 (ne perputhje me kerkesat e performances per modulet LED), SSH EN 61347-1 (ne perputhje me kerkesat e pergjithshme te sigurise) dhe SSH EN 61547 ne perputhje me Direktiven 2014/30/BE (lidhur me emetimet dhe shqetesimet elektromagnetike).
 - **Ndriqes prozhektor LED 150W per ndricimin ambjenti sportive:** Autorizim Prodhuksi/Distributori te autorizuar, te paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 61547 ne perputhje me Direktiven 2014/30/BE (lidhur me emetimet dhe shqetesimet elektromagnetike).
 - **Terminal per akses te kontrolluar me lexues karte dhe me PIN (nivel mbrojtje IP65):** Autorizim Prodhuksi/Distributori te autorizuar, te paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 50130-4 (lidhur me kerkesat per kontrollin e hyrjes dhe sistemet e alarmit), ne perputhje me Direktiven 2014/30/BE.
 - **Sirene alarmi:** Autorizim Prodhuksi/Distributori te autorizuar, te paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 54-3 (lidhur me sistemet e alarmit te zjarrit).
 - **Bolier 80 liter, uje te ngrohje:** Autorizim Prodhuksi/Distributori te autorizuar, te paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 50440 (efiçenca e ngrohësve elektrik me rezervuar uji), ne perputhje me Rregulloren 814/2013/BE (lidhur me kërkesat për ngrohësit e ujit dhe rezervuarët e ruajtjes së ujit të nxehtë).
 - **Kaldaje me Biomase kapaciteti 60-70kw:** Autorizim Prodhuksi/Distributori te autorizuar, te paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi ne perputhje me Direktiven Europiane 2014/68/BE ose Ligjin Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.
 - **Hidrant zjarri I jashtem DN 80:** Autorizim Prodhuksi/Distributori te autorizuar, te paraqitet katalog/skeda teknike perkatese, Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 14384 (standardi për hidrantët e zjarrit me shtylla).

2.3.8. Operatori ekonomik duhet te kete kontrate sherbimi/bashkepunimi me nje trupe inspektuese, e cila duhet te jete e akredituar sipas ISO/IEC 17020:2012 nga organizma kombetar ose nderkombetar lidhur me inspektimin dhe kolaudimin e sistemit te ngrohjes pas instalimit.

Per permbushjen e ketij kriteri duhet te paraqiten:

- Kontrate sherbimi/bashkepunimi me nje trupe inspektuese
- Certificate e akreditimit te trupes inspektuese sipas ISO/IEC 17020:2012 lidhur me inspektimin e kaldajave.

2.1 (Makineri, Pajisje)

- a) **Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje,** automjetet dhe pajisjet (**sipas tabelës**) te cilat duhet te jene ne pronesi te tij ose me qira te vertetuara keto me dokumentacionin perkates;

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10 – 20 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 3.5	1 cope	Pronesi ose me qera
Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Mineskavator	1 cope	Pronesi ose me qera
Autobetoniere	2 cope	Pronesi ose me qera
Autopompe betoni	1 cope	Pronesi ose me qera
Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir	1 cope	Pronesi ose me qera
Autovinç mbi 5 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Rul	1 cope	Pronesi ose me qera
Depozite uji 5000 l	1cope	Pronesi ose me qera
Matrapik per thyerje betoni	2cope	Pronesi ose me qera
Vibrator	2cope	Pronesi ose me qera
Kompaktor/Ngjeshes betoni	1 cope	Pronesi ose me qera
Pompe uji	1 cope	Pronesi ose me qera
Betoniere 0.25-0.5 m ³	2 cope	Pronesi ose me qera
Saldatrice	2 cope	Pronesi ose me qera
Aparat lidhje per fiber optike	1 cope	Pronesi ose me qera
Instrument per punime gjeodezike	1 cope	Pronesi ose me qera
Gjenerator	1 cope	Pronesi ose me qera
Kompresor	2 cope	Pronesi ose me qera

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, çertifikatë për*

transport mallrash.

- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.
- f) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Sqarim për ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 " Per Prokurimin Publik " neni 82 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 " Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021. **Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, I, j të pikes 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.**

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
• Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

				• nfor

macion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në

nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër³.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

